



REPUBLIKA KOSOVË / REPUBLIC OF KOSOVO	AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
Dep.	DPKI	ANTI-CORRUPTION AGENCY
Dep.		
Dep.		
Nr. fmq		
Broj stranice	02	
Nr. Prot	06-02-3671/22	
Bр. Прот		
Prot No		
Date		
Datum	29.08.2022	



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

**AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE
AGENCY FOR THE PREVENTION OF CORRUPTION**

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 29 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, lidhur me nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 25.08.2022, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbylljet rasti **AKK-DPKI-06-2612/22**, për zyrtarin e lartë z. Hydajet Hyseni Kaloshi, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, për shkak se është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Hydajet Hyseni Kaloshi, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI).

Ky rast ka filluar të trajtohet pasi është identifikuar se z. Hydajet Hyseni Kaloshi, krahas ushtrimit të funksionit publik Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, është edhe Kryetar në Organizaten joqeveritare “Shoqata e ish të burgosurve politikë” (në vijim: OJQ).

Fillimisht, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia), me qëllim të verifikimit të gjendjes së papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, ka kërkuar informatat për OJQ-në në fjalë nga Departamenti për OJQ në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Nga përgjigja e pranuar prej Departamentit për OJQ, zyrtari në fjalë figuronte të jetë Kryetar i OJQ-së, si më lartë.

Agjencia, e ka njostuar zyrtarin e lartë me shkresë zyrtare për fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj, është mbajtur takim me zyrtarin e lartë në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit. Gjatë këtij takimi z. Hyseni Kaloshi, është njostuar lidhur me faktet për rastin e tij, si dhe është udhëzuar për veprimet që duhet t'i ndërmerr për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit me ushtrimin e funksionin publik.

Zyrtari i lartë, gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të jetë Kryetar në Organizata joqeveritare, për faktin se një situatë e tillë paraqet gjendje të konfliktit të interesit. Kjo ndalohet



me dispozitën e nenit 14 paragrafi 1, të Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në të cilën shprehimisht thuhet se: “*Zyrtari i lartë mund të jetë anëtar i organit drejtues, me përjashtim të funksionit drejtues, të organizatës joqeveritare nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës, veprimtarive humanitare dhe të ngjashme pa të drejtë shpërblimi me pagesë, përvëç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe të tjera të lidhura me to*”.

Zyrtari i lartë z. Hyseni Kaloshi, është pajtuar me konstatimet e Agjencisë dhe ka premtuar se menjëherë do të ndërmarrë veprime në mënyrë që ta shmang gjendjen e konfliktit të interesit.


Ndërkoftë, Agjencia ka pranuar shkresën zyrtare nr.(06-2577/22) me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë ka dhënë dorëheqje nga funksioni drejtues në organizatën joqeveritare “Shoqata e të burgosurve Politikë”.

Pas analizimit të informatave si më lartë, Agjencia konstatoi se me veprimet që i ka ndërmarrë zyrtari i lartë, është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11, të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, lidhur me nenin 29 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korruptionit, Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:


Vilim Buleshkaj
Drejtor i Agjencisë për
Parandalimin e Korruptionit

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)